



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini, U.D Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

Datë: 12/02/2018
Nr. 020/162

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 01-110/05-96 për bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm me komunën e Kirchhain
I miratuar më datë më datë: 31.01.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.02.2019


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr. 01-110/05-96 për bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm me komunën e Kirchhain	Vendimi Nr. 01-110/05-96 për bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm me komunën e Kirchhain është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04-L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal përkatësisht me nenin 6 i cili e përcakton se procedura për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal fillohet përmes nismës. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal parashtrohet me shkrim nga: Kryetari i Komunës dhe 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal parashtrohet me shkrim nga së paku 5 % e qytetarëve të komunës me të drejtë vote. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal duhet të përmbajë qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, komunitet e përfshira në bashkëpunim, formën e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet e mundshme financiare nga bashkëpunimi, si dhe çështje të tjera të rëndësishme mbi themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal. Kryetari i Komunës ka për detyrë që brenda tri (3) javëve nga dita e parashtrimit të nismës t'ia jep Kuvendit Komunal mendimin e tij me shkrim dhe të arsyetuar lidhur me iniciativën apo propozimin në fjalë, përveç nëse nismën e ka parashtruar vet kryetari i komunës.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimin të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Sokol Haliti, gradonačelnik opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Čerkini, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Datum: 12/02/2018 Br. 020/162
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akata opštine Vitina	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i nadgledanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br. 01-110/05-96 o međuopštinskoj saradnji za održivu međuopštinsku saradnju sa opštinom Kirchhain
Usvojena dana: 31.01.2019
Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 02.02.2019

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog akta opštine, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Neusklađenosti opštinskog akta podnetog za razmatranje zakonitosti je kao što sledi:

Br.	Formulisane u opštinskom aktu	Zakonska odredba po kojoj je akt opštine neusklađen.
1.	Odluka br. 01-110/05-96 za održivu međuopštinsku saradnju sa opštinom Kirchhain	Odluka br. 01-110/05-96 za održivu međuopštinsku saradnju sa opštinom Kirchhain je u suprotnosti sa Zakonom br. 04-L-010 o međuopštinsku saradnju sa članom 6 koji određuje da: Procedura o osnivanju međuopštinske saradnje počinje putem inicijative. Inicijativa za osnivanje međuopštinske saradnje se podnosi pismenim putem od strane: gradonačelnika opštine I 1/3 članova Skupštine opštine. Inicijativa za osnivanje međuopštinske saradnje se podnosi pismenim putem od strane: 3.1.najmanje 5 % građana opštine sa pravom na glas. Inicijativa za osnivanje međuopštinske saradnje treba da sadrži svrhu saradnje, ovlašćenja u vezi sa saradnjom, opštine uključene u saradnji, oblik saradnje, očekivane beneficije/koristi, moguće finansijske implikacije iz saradnje, kao i ostala pitanja koja su značajna za osnivanje međuopštinske saradnje. Gradonačelnik opštine ima obavezu da u roku od tri (3) nedelje od dana prijema podnošenja inicijative da Skupštini opštine predloži svoju pismenu i obrazloženu ideju u vezi sa inicijativom ili navedenim predlogom, osim ako inicijativa nije podneta od strane samog gradonačelnika.

Na osnovu gore navedenog, ministarstvo administracije lokalne samouprave zahteva od skupštine opštine/ gradonačelnika opštine da preduzmu konkretne mere za usklađivanje akta opštine sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-02-2019
01-110/05-96



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm me Komunën e Kirchhain

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON për bashkëpunim ndërkomunal të qëndrueshëm me Komunën e Kirchhain. Qëllimi i bashkëpunimit ndërkomunal të qëndrueshëm ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Komunës së Kirchhain, janë partneritetet e qëndrueshme në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

Neni 2

Në kuadër të këtij bashkëpunimi ndërkomunal, do të realizohen objektivat e parapara në kuadër të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Neni 3

Komuna e Vitisë dhe Komuna e Kirchhain, për dy vite kanë pasur një bashkëpunim të mirë, por që komunat partnere janë të interesuar që ky bashkëpunim të vazhdojë.

Neni 4

Komunat partnere kanë prezantuar rezultatet pas përfundimit të një bashkëpunimi dyvjeçar të komunave partnere mbi agjendën 2030, në të cilën Komuna e Vitisë ka bashkëpunuar me Komunën Kirchhain nën Hessenin i Gjermanisë si dhe fshatrat e tyre. Smira me Kleinselheimin në një fazë pilotë.

Neni 5

Ky vendim hyjë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Poshjetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. MAPL-së
3. Komunës së Kirchhain
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Naim Pira